

Për:	Operatorin Ekonomik: PRO MEDICAL SH.P.K., Rr. Kadri Zeka, 70000, Ferizaj Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	27.12.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **27.12.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – së**, me Numër të prokurimit: **623-22-11331-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-054-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – së**, me Numër të prokurimit: **623-22-11331-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-054-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **20.12.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – së**, me Numër të prokurimit: **623-22-11331-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-054-1-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **PRO MEDICAL SH.P.K.** me adresë në **Ferizaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIME MJEKËSORE PËR NEVOJAT E QKMF – së**, me Numër të prokurimit: **623-22-11331-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-22-054-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **20.12.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **27.12.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar kriteret sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit;

Ju bashkëngjisim edhe njëherë Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1: Autorizim nga prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Te dëshmohet se Operatori është i Autorizuar nga Prodhuesi ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi me numër të prokurimit si me lart, (me të dhëna detaje të kontaktit për prodhuesin adresë, websajti, numri i telefonit, emali);

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, keni prezantuar një Autorizim nga prodhuesi, mirëpo i njëjti nuk e plotëson, kërkesën dhe dëshminë e përcaktuar në Dosjen e Tenderit nga AK, në këtë Autorizim mungon Numri i Prokurimit;

Dokumenti një fjale nuk mund të kërkohej në bazë të Nenit 72, paragrafi 3. i cili përcakton si në vijmë: Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së, i cili përcakton si në vijmë: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, gjatë zbatimit të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor gjithmonë është bazuar në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, si në vijim, citoj: *“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë...”* Po ashtu sipas paragrafit 1 të nenit 6 të këtij ligji, ku cekë se: *të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.*

Po ashtu Konform RrUOPP-së neni 41.12 citon: *“AK do t’i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuar në njoftimin e kontratës/dosjes e tenderit”*

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret sipas Njoftimit për kontratë/dosjes e tenderit dhe Specifikave teknike.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>